

**PROCESVERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT “BLERJE KËPUCËSH
PËR GARDËN E REPUBLIKËS”**

I mbajtur sot në datë 11.06.2024 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje këpucësh për Gardën e Republikës”, me fondi limit 19,998,038 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tridhjetë e tetë) lekë (pa TVSH) ose 199.442 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzet e dy) Euro pa TVSH.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote pasi kemi të bëjmë me të njëjtën familje mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori. Në rast se kjo procedure do ndahej në lote do të krijonte pasiguri autoritetit kontraktor se artikujt e kërkuar do të jenë e njëjtë për të gjithë punonjësit e gardës, ku modeli i përcaktuar, materialet e përdorura, cilësia në prodhim e deri tek tonacioni i ngjyrave nuk duhet të ndryshojnë, jo vetëm brenda një pale këpucësh të një punonjësi, por as edhe ndërmjet punonjësve me njëri-tjetrin, pra nga prodhimi i lëndës së parë, prodhimi i fijeve dhe deri te ndërtimi i saj duhet të realizohet në mënyrë uniforme. Pra nga ana teknike dhe organizative është e nevojshme kryerja e furnizimit me këpucë vetëm me një lot.

NJËSIA E PROKURIMIT